

## FORMATION OF COMPOUND WORDS IN FAIK KONICA'S PROSE FORMIMI I FJALËVE TË PËRBËRA NË PROZËN E KONICËS

Selvije SELMANI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Primary school „Simche Nastovski“, Jegunoc, the Republic of North Macedonia

<sup>2</sup>Corresponding author: selmaniselvije@gmail.com

### Abstract

In enriching the lexicon of the Albanian language, besides other ways, composition plays an important role also. In this paper, are analyzed the compound words in the prose “Four tales from Zulluland”, “Albania as it seemed to me”, “Dr. Gjilpëra (Needle) discovers the roots of the drama of Maumrras”, “Albania – the Rocky Garden of Southeast Europe”. “ and other writings (*That strange Country – Albania, Racial origin, Albanians: the Keys to Understanding their Life and their Nature, Painterly Kilt, Martial Traits, Language and literature, Bejlers and Bajraktars, Language and Literature, Religion, Farewell Albania of the Bird*) from Faik Konica.

Through the method of word analysis and classification, compound words are divided according to their lexical-grammatical value, that is, grouped into nominal compound, compound modifier and adverbial compound words and according to the construction, according to the lexical-grammatical value of the members.

The results of the conducted research prove that the language of Konica is quite rich in compound words of which compound modifier of the noun + adjective type dominate the most.

**Key words:** *Faik Konica, compound words, the nominal compound, the compound modifier and the adverbial compound.*

### Abstrakt

Në pasurimin e leksikut të gjuhës shqipe, pos mënyrave të tjera, rol të rëndësishëm luan edhe kompozimi.

Në këtë punim janë analizuar fjalët e përbëra në prozën “Katër përralla nga Zullulandi”, “Shqipëria si m’u duk”, “Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Maumrrasit”, “Shqipëria – kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore” dhe shkrime të tjera (*Ai vend i çuditshëm – Shqipëria, Prejardhja racore, Shqiptarët: çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre, Fustanella piktorike, Vetitë luftarake, Bejlerët dhe bajraktarët, Gjuha dhe letërsia, Feja, Lamtumirë Shqipërisë së Zogut*) të Faik Konicës.

Përmes metodës së analizë së fjalëve dhe klasifikimit është bërë ndarja e fjalëve të përbëra sipas vlerës leksiko – gramatikore, pra të grupuara në kompozita emërore, mbiemërore dhe ndajfoljore dhe sipas ndërtimit, sipas vlerës leksiko – gramatikore të gjymtyrëve.

Rezultatet nga hulumtimi i kryer dëshmojnë se gjuha e Konicës është mjaft e pasur me fjalë të përbëra nga të cilat më shumë dominojnë kompozitat mbiemërore të tipit emër + mbiemër.

**Fjalët çelës:** *Faik Konica, fjalët e përbëra, kompozita emërore, kompozita mbiemërore, kompozitat ndajfoljore.*

## Hyrje

Kompozitat në gjuhën shqipe ndahen në këpujore (nënrenditëse) dhe përcaktore (bashkërenditëse). Këto të fundit përbëjnë edhe numrin më të madh të fjalëve të përbëra në gjuhën shqipe. Në këtë punim janë analizuar të gjitha fjalët e përbëra, të cilat i kemi ndeshur në prozën e Konicës, duke i veçuar sidomos ato fjalë të cilat nuk na dalin të pasqyruara në fjalorët e marrë për krahasim.

Studimi i kompozitave të shqipes filloi që nga gjysma e shekullit XIX. Si nismë e mbarë të një tradite të këtitillë janë gramatikat e Konstantin Kristoforidhit, Sami Frashërit dhe shumë studime të ndryshme të dashamirësve të gjuhës, të cilët kanë dhënë kontribut në këtë fushë të gjuhësisë (Millaku, 2011:19). Fjalët e përbëra, sidomos nëpër gramatikat, i kanë grupuar edhe sipas vlerës leksiko-gramatikore. Ky grupim formal është i lehtë dhe mund të bëhet sa herë që ndeshemi me fjalë të përbëra në mësimin e gjuhës, sepse ndriçon kuptimin e njësisë në tërësi“ (Thomai, 2002:165).

Kompozimi është një mënyrë fjalëformimi me anë të së cilës krijohen fjalë të reja që kanë në përbërjen e tyre dy a më shumë tema motivuese; njëra nga këto (tema mbështetëse, që është zakonisht e dyta) e formëson gramatikisht gjithë kompozitën, ndësa tema tjetër (ose temat e tjera, kur janë më shumë se një) është e asnjansuar nga pikëpamja e kuptimeve të saj gramatikore (Gramatika e gjuhës shqipe, 1995:70).

Në prozën e Konicës kemi hasur disa fjalë që nga përbërja strukturore janë fjalë të përbëra dhe përbëhen nga dy morfema rrënjore siç janë fjalët: *zemërligësi, fatbardhësi, gjakftohtësi, mendjelehtësi, bujkrobëri, kryenaltësi, udhëheqësi, shpirtmadhësi*, por këto mund t'i grupojmë te fjalët e prejardhura për shkak se në aspektin e fjalëformimit është shumë e qartë se këto fjalë janë të prejardhura me prapashtesim dhe ndryshe quhen kompozita të rreme.

## Materiali dhe metodat

Formimi i fjalëve të përbëra në prozën e Faik Konicës është bërë përmes metodës së analizës dhe klasifikimit për të përcaktuar vlerën leksiko – gramatikore të tyre, pra në janë kompozita emërore, mbiemërore ose ndajfoljore. Ndarja e fjalëve është bërë edhe sipas ndërtimit të gjymtyrëve. Çdo fjalë e analizuar përkon me origjinalitetin e veprave të Konicës. Fjalët e përbëra janë krahasuar me disa fjalorë, si: Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe (1976), Fjalorin e gjuhës shqipe (1980), Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe (2015) dhe Fjalorin e gjuhës shqipe (2020).

## Rezultatet

Formimi i fjalëve të përbëra në prozën e Faik Konicës zë një vend mjaft të veçantë duke na dëshmuar edhe njëherë se kjo mënyrë fjalëformimi në gjuhën shqipe është mjaft prodhimore. Më poshtë i kemi të dhëna të gjitha fjalët e përbëra, të cilat i kemi hasur në veprën e tij.

## Kompozita emërore

### Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + emër prejfoljor i vepruesit

Në ndërtimin e kompozitave emër + emër prejfoljor i vepruesit veçojmë kompozitën kartnxirës, e cila nuk del e pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim. Me fjalën kartë në Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe 1976 dalin leksemat: *kartmonedhë, kartëpostale*,

*kartëvizitë*, në Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe 2015 dalin fjalët: *kartëmonedhë*, *kartëpagesë*, *kartëpostale* *kartëvizitë*, ndërsa në Fjalorin e gjuhës shqipe 2020 fjalët: *kartmonedhë* dhe *kartëpostale*.

**flamurbajtës** (... ai quhej bajraktar, domethënë *flamurbajtës* ...) (“Bejlerët dhe bajraktarët”, f. 287).

**gjellëbërës** (atë e mësojnë që në fëmijëri të jetë *gjellëbërëse* e mirë ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 254).

**kartënxirës** (... kanë qenë më të mëdhenjtë *kartënxirës* të botës ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 58).

**mikpritës** (... tek të dy vëmë re detyrimin e *mikpritësit* ...) (“Bjelerët dhe bjarkatarët”, f. 291).

**punëdhënës** (... i shkakton shpërdorimi i besimit nga *punëdhënësit* ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 225).

**taksambledhës** (... si xhandar ose si *taksambledhës* ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 224).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + emër prejfoljor veprimi**

Te ndërtimi emër + emër prejfoljor veprimi fjalët e përbëra janë të mbarë shqipes.

**dorëshkrim** (... ka libra dhe *dorëshkrime*? ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 111).

**dorëtrokitje** (...një breshër *dorëtrokitjesh* nga zalli tjetër...) (“Katër prralla nga Zullulandi”, f. 26).

**gjakmarrje** (... meqë *gjakmarrja* ka qenë një ngjarje e përditshme ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 194).

**hakmarrje** (... ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve ka disa shekuj *hakmarrjeje* ...) (“Prejardhja racore”, f. 219).

**letërkëmbim** (... në *letërkëmbimin* e lord Bajronit me Shelin ka një letër ...) (“Shqipëria - vend shkëmbor i Evropës juglindore, f. 188).

**mikpritje** (... është folur shumë për *mikpritjen* e shqiptarëve ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 238).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + emër çfarëdo (i parmë a i prejardhur)**

Te ndërtimi i tipit emër + emër çfarëdo (i parmë a i prejardhur) veçojmë kompozitat: *gjysmëtasë*, *kafeshantane*, *pendë – kallamar*, të cilat nuk i kemi hasur në FGJSH (2020), FDGJSH (2015), FDGJSH (1976), FGJSSH (1980).

**atdhe** (... bota është *atdheu* i madh ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 100).

**fjalëkryqe** (... ashtu siç janë *fjalëkryqet* ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 240).

**gjysmëtasë** (... nxirret kafeja turke me filxhanë kafeje ose *gjysmëtasë* ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 256).

**juglindje** (... nga gjithë evropianët e *juglindjes* ...) (“Ai vend i çuditshëm Shqipëria”, f. 178).

**kafeshantane** (... mund të shkojë kohën e tij në *kafeshantanet* me famë ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 106).

**kartëmonedha** (... ushtarët e huaj i paraqesin kuponat e për cigare si *kartëmonedha* ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 240).

**këmbëngulje** (... me një *këmbëngulje* domethënëse ...) (“Bejlerët dhe bajraktarët”, f. 287).

**mëmëdhe** (... humbi këtu një rat të rrallë, të shpëtojë *mëmëdhenë* ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 32).

**pendë - kallamar** (... vuri re në xhep të jelekut të doktorit një *pendë – kallamar* ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 131).

**pikënisje** (... janë interesante si *pikënisje* për opinionet ...) (“Shqipëria – kopshti shkëmbor i Evropës Juglindor”, f. 186).

**pikëpamje** (... Indipendenca shqiptare në *pikëpamjet* historike ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 45).

**udhëheqje** (... nën *udhëheqjen* e dy sulltanëve të fuqishëm ...) (“Vetitë luftarake”, f. 272).

**vargmale** (... Shqipëria rrethohet nga tri anët prej *vargmalesh* pothuaj të pakapërcyeshme ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 187).

**vendbanim** (... në disa *vendbanime* shtëpitë janë të përhapura aq larg ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 197).

**vendlindje** (... është mjaft interesante që Berati ka qenë *vendlindja* e Proleme Lagosit ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 201).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema ndajfolje + emër**

Fjalët e përbëra të tipit ndajfolje + emër nuk janë të shumta. Ndajfolja zakonisht bashkohet me emra të prejardhur që formohen me prapashtesat –im dhe –je.

**keqkuptim** (... edhe lidhur me Shqipërinë e sotme ka një *keqkuptim* të përgjithshëm ...) (“Ai vend i çuditshëm Shqipëria”, f. 181).

**keqpërdorim** (... po nga ia *keqpërdorim* nga i cili vuan fjala “racë” ...) (“Prejardhja racore”, f. 206).

**mirëbesim** (... e përfytyrojnë me *mirëbesim* se përdormi i gjuhës shqipe ...) (“Ai vend i çuditshëm Shqipëria”, f. 178 ...).

**mirënjohje** (... si *mirënjohje* që perëndia e kish shëptuar nga rreziku ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 137).

**mirësjellja** (... si karakteristika të shqiptarëve janë: kalorësia, *mirësjellja*, pavarësia ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 230).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema përemër ose numëror + emër**

**vetëdiqe** (... ai i dha kombit një *vetëdiqe* uniteti ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 198).

**vetëkënaqësi** (... injoron gjërat më të holla të jetës dhe *vetëkënaqësisë* ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 243).

**vetëmbrojtje** (... po t’ish nevojë, si *vetëmbrojtje* të jetës ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 137).

**vetëpërmbajtja** (... njerëzve të rinj shpesh u mungon *vetëpërmbajtja* ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 233).

**vetëqeverim** (... u zgjoi edhe zulluve oreksin për *vetëqeverim* ...) (“Katër prralla na Zullulandi”, f. 7).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + mbiemër**

Në ndërtimin e tipit emër + mbiemër kemi gjetur fjalën e përbërë *derëbardhi*.

**derëbardhi** (... *derëbardhi* i pagdhendur beson dhe thotë ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 67).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema folje + emër**

Faik Konica me këtë mënyrë ndërtoi kompozitat: *bamirës, marrëveshje, marrëdhënie, vëmendje*.

**bamirës** (... për të shpëtuar vendlindjen nga *bamirësit* e tij ...) (“Vetitë luftarake”, f. 275).

**marrëveshje** (... kjo *marrëveshje* u vendos me një shkëmbim ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 56).

**marrëdhënie** (... dhe *marrëdhëniet* diplomatike vazhdojnë ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 75).

**vëmendje** (... ato tërheqin me forcë *vëmendjen* te malet e Shqipërisë ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 189).

## Kompozitat mbiemërore

### Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + emër (emër prejfoljor i vepruesit)

Te ndërtimi i tipit emër + emër (emër prejfoljor i vepruesit) veçojmë kompozitat: kripëpiper, morrvrasës, përshtypjelënëse, syçakaj, të cilat nuk dalin te pasqyruara në fjalorë. Te FDGJSH (2015) me fjalën kripë dalin të pasqyruara ndërtimet: *kripëdashës (mb)*, *kripëmbajtës (mb)*; me fjalën morr: *morracak (mb)*, *morrash (mb)*, ndërsa numri i kompozitave të formuara me fjalën sy është mjaft i madh, por nuk na del e pasqyruar fjala *syçakaj*.

**gjakpirës** (... të egër dhe të tërbuar, *gjakpirës* me famë ...) (“Katër prralla nga Zullulandi”, f. 7).

**kripëpiper** (... qe një njeri me mjekër *kripëpiper* dhe me sy të vegjël ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 135).

**morrvasës** (... me një toz morrvrasës ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 115).

**përshtypjelënëse** (... ishte një pamje e shkëlqyer dhe *përshtypjelënëse* ...) (“Fustanella piktorike”, f. 265).

**syçakaj** (... kumarxhinj të ngrysur, spiunë *syçakaj* ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 117).

**vdekjeprurës** (... zjarri që u derdhej nga sipër ishte *vdekjeprurës* ..) (“Vetitë luftarake”, 268).

### Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + mbiemër

Kjo mënyrë fjalëformimi është mjaft prodhimtare dhe përbën numrin më të madh të kompozitave. Nga kompozitat e formuara nga tema emër + mbiemër veçojmë kompozitën *mjegullveshur*, e cila nuk na del e pasqyruar në fjalorët e marrë për krahasim, në FGJSSH (1980), FDGJSH (1976), FDGJSH (2015) dhe FGJSH (2020).

**fatkeq** (... një tipar pa dyshim *fatkeq* i shqiptarëve ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 237).

**fytyrërrumbullak** (... Zylfikar agai *fytyrërrumbullak* ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 138).

**gjysmanalfabet** (... një seri *gjysmanalfabet* mund shumë lehtë t’i çkuptojë ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 48).

**gjysmëfeudale** (... njësisht *gjysmëfeudale* ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 332).

**këmbëzbathur** (... të rrokulliset *këmbëzbathur* kur ka dëborë...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 250).

**kokëfortë** (... nga kundërshtarët më *kokëfortë* ...) (“Prejardhja racore”, 215).

**kokëngjeshur** (... u përgjigj përsëri me zjarr agai *kokëngjeshur* ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 139).

**kokëshkretë** (... veç kësaj turqit mendojnë se shqiptarët janë *kokëshkretë* ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 223).

**kryelartë** (... e bën të bindurit një zakon *kryelartë* ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 61).

**kryeulur** (... me sy të mbyllur dhe *kryeulur* ...) (“Katër prralla nga Zullulandi”, f. 18).

**vetulltrashë** (... me mustaqe majëtatpjetë, *vetulltrashë* ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 138).

**mendjelehtë** (... për grekët *mendjelehtë* ...) (“Feja”, f. 309).

**mesholla, leshverdha, sybardha** (... vuri re një ditë dy vajza të bukura nga fshati Shën – Mëri, nja 18 vjetsh, *mesholla, leshverdha, sybardha* ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 134).

**mjegullveshur** (... dhe Irag Pindit çuka *mjegullveshur* ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 188).

**sypatrembur** (... kanë treguar një veprimtari *sypatrembur* ...) (“Vetitë luftarake”, f. 271).

**syzi** (... tani burrë 29 vjetsh, *syzi*, me ballë të gjerë ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 99).

**shpirtmadh** (... për një burrë *shpirtmadh* si Mbret Zogu ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 42).

**shpirtmira** (... tri motrat tërheqëse dhe *shpirtmira* të Zogut...) (“Lamtumirë Shqipërisë së Zogut”, f. 324).

**shtatlartë** (... tipi *shtatlartë* flokëverdhe ...) (“Prejardhja racore”, f. 207).

**verilindore** (... me përjashtim të viseve *verilindore* ...) (“Prejardhja racore”, f. 207).

**veskeq** (... kam frikë se jeni të mbyllur në një qar *veskeq* ...) (“Katër prralla nga Zullulandi”, f. 23).

**zemërbardhë** (një çinovnik *zemërbardhë* dhe i dhënë pas vodikës ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 86).

**zemërrulur** (... një njeri *zemërrulur* dhe i paditur nga librat ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 166).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + përemër i pacaktuar**

Formimi i fjalëve sipas ndërtimit emër + përemër i pacaktuar është hasur te fjala *gjuhëshumë*.

**gjuhëshumë** (... negri *gjuhëshumë* këndoi ...) (“Katër prralla nga Zullulandi”, f. 18).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema ndajfolje + emër dhe anasjelltas**

Në krijimtarinë e Faik Konicës me ndërtimin ndajfolje + emër dhe anasjelltas janë gjetur pak mbiemra.

**fuqiplotë** (... se pritja e papritur nuk iu bë Ministrin *fuqiplotë* të Washingtonit ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 35).

**kuptimplote** (... gjëja më *kuptimplote* nga të gjitha ...) (“Shqiptarët çelësat për të kuptuar jetën dhe natyrën e tyre”, f. 239).

**mirëbërës** (... të veprimit *mirëbërës* si Abraham Lincol-in ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f. 77).

**mirënjohëse** (... prej Fuqive Aliate *mirënjohëse* pas rënies së Napoleonit ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 94).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema numëror (a përemër i pacaktuar) + mbiemër**

Në prozën e Konicës, ashtu si edhe në mbarë gjuhën shqipe, mënyra e formimit të kompozitave nga një numëror (a përemër i pacaktuar) + mbiemër nuk është shumë prodhimtare.

**disangjyrësh** (... në mes një brez mëndafshi *disangjyrësh* ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 135).

**disashekullor** (... ia ka arritur të kapërcejë izolimin *disashekullor* ...) (“Bjelerët dhe bajraktarët”, f. 293).

**dhjetëvjetsh** (... një vajzë *dhjetëvjetsh* hyri me një tepsi ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 138).

**dykatëshe** (... janë zakonisht ndërtesa një – a *dykatëshe* ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 194).

**nëntëvjeçar** (... ishte ky djalosh *nëntëvjeçar* ...) (“Vetitë luftarake”, 274).

**shumëngjyrëshe** (... gjatë gjithë këtyre viteve të një historie *shumëngjyrëshe* ...) (“Ai vend i çutishëm Shqipëria”, f. 178).

**trikatëshe** (... janë ndërtuar shtëpi *trikatëshe* ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 202).

### **Formimi i fjalëve të përbëra mbiemra me dhe pa zanoren lidhëse o**

Mbiemrat e formuar me ose pa zanoren lidhëse o nuk gjejnë shumë përdorim në gjuhën e Faik Konicës, por që gjithsesi janë të pranishme dhe kjo na dëshmon për njohje të mirë të sistemit fjalëformues të gjuhës shqipe nga ana e shkrimtarit.

**Austro – Hungareze** (...Monarkia *Austro – Hungareze* ...) (“Shqipëria si m’u duk”, f.45).

**greko – romake** (... e pashë me interes koleksionin e antikitetëve *greko – romake* ...) (“Shqipëria – vend shkëmbor i Evropës juglindore”, f. 197).

**greko – sllave** (... qëllimet e propagandës *greko – sllave* ...) (“Bejlerët dhe bajraktarët”, f. 287).

**greko – shqiptar** (... për caktimin e kufirit *greko – shqiptar* ...) (“Fustanella piktorike”, f. 265).

**politik – shoqëror** (... për shkak të sistemit *politik – shoqëror* ...) (“Fustanella piktorike”, f. 257).

### **Kompozitat ndajfoljore**

Kompozitat ndajfoljore janë shumë të pakta në prozën e Konicës. Janë gjetur vetëm dy fjalë të përbëra të këtij lloji.

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + emër**

**këmbëkryq** (... e gjetnë aganë *këmbëkryq* ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 135).

### **Formimi i fjalëve të përbëra nga tema emër + ndajfolje**

**kokëtatëpjetë** (... ky Habibullah merton të varet *kokëtatpjetë* ...) (“Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit”, f. 163).

### **Përfundim**

Formimi i fjalëve të përbëra në prozën e Konicës është mjaft i pasur dhe prodhimtar. Fjalët e përbëra janë formuar nga bashkimi i dy temave rrënjore që mund të jenë emërore, mbiemërore, foljore e ndajfoljore. Janë hasur fjalë të përbëra ku gjymtyrët janë të barasvlershme, që quhen edhe kompozia këpujore dhe janë në numër më të vogël dhe fjalë të përbëra ku njëra gjymtyrë e përcakton tjetrën dhe quhen përcaktore. Kompozitat përcaktore janë në numër shumë të madh. Të gjitha kompozitat janë grupuar sipas ndërtimit, sipas vlerës leksiko-gramatikore të gjymtyrëve që e përbëjnë kompozitën dhe kjo na ka dhënë një rezultat se mënyra e formimit të kompozitave mbiemërore, të ndërtuara nga tema emër + mbiemër, është shumë prodhimtare, si: *kokëshkretë, vetulltrashë, mjegullveshur, sypatrembur, syzi, shpirtmadh* etj., ndërsa te kompozitat emërore dominon ndërtimi emër + emër çfarëdo (i parmë a i prejardhur) si: *gjysmëtas, kafeshantane, pendë – kallamar* etj. Nuk mungojnë edhe ndërtimet e tipit: *emër + emër prejfoljor i vepruesit, emër + emër prejfoljor i veprimi, ndajfolje + emër, përemër ose numëror + emër, numëror (a përemër i pacaktuar) + mbiemër, ndajfolje + emër dhe anasjelltas, emër + përemër i pacaktuar, folje + emër*. Në prozën e Konicës, kompozitat ndajfoljore janë shumë të pakta.

## **BIBLIOGRAFIA**

- [1]. *Gramatika e gjuhës shqipe* (1995). Morfologjia I. Tiranë.
- [2]. Konica, F. (2016). *Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit*. Tetovë: Çabej.
- [3]. Konica, F. (2016). *Katër prralla nga Zullulandi*. Tetovë: Çabej.
- [4]. Konica, F. (2016). *Shqipëria si m’u duk*. Tetovë: Çabej.
- [5]. Konica, F. (2016). *Shqipëria-Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore dhe shkrime të tjera*. Tetovë: Çabej.
- [6]. Millaku, Sh. (2011). *Studime gjuhësore I (Kompozitat)*. Prishtinë.
- [7]. Thomai, J.(2002). *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë.